



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:251458

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05637826

2023:279677

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çështjen penale ndaj të pandehurit H.H nga fsh....-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr. 1646/23 të dt.13.12.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 24.04.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Avdulla Abedini dhe të pandehurit, me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare, av.Sh. C., me dt.29.04.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me dt.30.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri H.H nga fsh...., Komuna Kacanik, rruga "... " nr. .. , i lindur më dt...., nga i ati Sh... dhe e ëma A..., e gjinisë V..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i 2 femijeve, ka të kryer shkollën e mesme , i pa punë –bujk , i gjendjes së mesme ekonomike, me nr.personal:..

ËSHTË FAJTOR

Sepse nga data e papërcaktuar deri më datë 26.10.2023, rreth orës 13.40, në shtëpinë e tij në fshatin ...- Komuna Kaçanik, i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm për armët në Kosovë, ka mbajtur në pronësi, kontroll dhe posedim të paautorizuar një pushkë automatike ..., prodhim kinez, kalibër 7.62, me numër serik ... dhe një karikator i zbrazët pa fishekë, të cilat ditën kritike gjatë një kontrolli nga ana e policisë i janë gjetur dhe sekuestruar,

Me këtë veprim i pandehuri H.H, ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 paragrafi 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,43,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 750.00 € (shtatëqind e pesëdhjetë euro).

I pandehuri është i obliguar që dënimin me gjobë t'a paguajë brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe atë në tri këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t'a zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumen prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 20,00€, si dhe taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimin në shumën prej 20.00€, në afat të njejtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

Në pajtim me nenin 366 paragrafi 3 të KPRK-së dhe nenit 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPP-së, të pandehurit I konfiskohet një pushkë automatike AK 47, prodhim kinez, kalibër 7.62, me numër serik ... dhe një karikator i zbrazët pa fishek.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën: PP/II.nr. 1646/23 të dt.13.12.2023, e akuzoi te pandehurin H.H nga fsh....-Kaçanik, për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Në bazë të kësaj aktakuze, me dt.24.04.2024, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me te cilin rast, prokurori i shtetit Avdulla Abedini me rastin e prezentimit te aktakuzës, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së parshtuar me shkrim pranë kësaj gjykate.

I pandehuri ne fjalën e tij ne pyetjen e gjyqtarës deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza dhe shton faktin se arma në fjalë ka qenë e salduar komplet dhe nuk është përdorur, dhe se nuk e ka ditur që ka mundur që t'a legalizojë të njëjtën si armë dekorative, prandaj nën këto rrethana i kërkon gjykatës që me rastin e marrjes vendimit t'i shqiptohet një dënim sa me i ulët që të jete e mundur.

Prokurori i shtetit ne fjalën e tij deklaroi se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i akuzuar per veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, pasi që një pranim i tillë u bë vullnetarisht nga ana e të pandehurit si dhe është në përputhje me dispozitën e nenit 242 të KPPK-së. Andaj i propozon gjykatës që t'a miratojë këtë pranim të fajësisë nga i pandehuri, pasi që pranimin e fajësisë e bëri pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij. Gjkata me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit ne kuptim të nenit 70 të KPRK-së, si rrethanë lehtësuese të marrë parasysh pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ndërsa si rrethana rënduese gjykata të merr shkallen e përgjegjesisë penale, rrezikshmërinë e veprës penale si dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, dhe te njëjtit t'i caktojë një dënim me gjobe me lartësi prej 1500 €, për faktin se nga armët te cilat gjenden tek qytetarët, e të cilat nuk janë të legalizuara shpesh herë ndodh që edhe të njëjtat të përdoren për kryerjen e veprave tjera penale me pasoja të rënda. Prokurori po ashtu i propozon gjykatës që në pajtim me nenin 366 par. 3 te KPRK-së, të konfiskohet arma dhe karikatorit i përshkruar si në dispozitiv të kësaj aktakuze .

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Sh. C., në fjalën e tij në shqyrtim fillestar deklaroi se, pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturin e tij, duke e këshilluar rreth veprës penale për të cilën akuzohet dhe duke i sqaruar benefitet që rrjedhin nga pranimi i fajësisë, i njëjti vendosi që t'a pranojë fajësinë. Sa i përket rrethanave lehtësuese gjykatës i propozon që, me rastin e caktimit të dënimit të merr parasysh rrethanën që është i pagjykuar më parë, madje as për këso vepra penale, e veqanërisht pranimin e fajësisë në seancën e shqyrtimit fillestar, shkallën e ulët të rrezikshmërisë të kësaj vepre penale, meqë arma ka qenë jashtë funksionit dhe nuk mund të përdorej, dhe se e njëjta ka qenë e përpunuar për të shërbyer thjesht si dekor apo si diçka e vjetër. Në lidhje me propozimin e Prokurorit të shtetit sa i përket lartësisë së dënimit, pajtohet pjesërisht, andaj i propozon gjykatës që sa i përket lartësisë së dënimit, të merr parasysh edhe gjendjen ekonomike të pandehurit, i cili është i gjendjes së mesme ekonomike, dhe lartësia e tillë e propozuar nga prokurori, është një shumë e lartë nga e cila dhe mund të dëmtohet relativisht shumë gjendja pasurore e të mbrojturit të tij. Prandaj i propozon gjykatës që të shqyrtojë mundësinë e shqiptimit të dënimit më të ulët me gjobë, por nëse shqiptohet një lartësi e tillë e propozuar nga Prokuroria, atëherë fton gjykatën që të shqyrtojë mundësinë e ndonjë dënimi me gjobë të kushtëzuar.

I pandehuri, e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij.

Pas dëgjimit të palëve, gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 2 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPK-së, kështu që si rrethanë posaqërisht lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, në tërësi në seancën e shqyrtimit fillestar, duke shprehur pendesë për veprimin e tij dhe duke i premtuar gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, bazuar në evidencën e gjykatës, i njëjti nuk evidentohet për raste të tilla apo të tjera penale, ndërsa

rrethanë të posaqme rënduese për te pandehurin gjykata gjeti rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin H.H , i akuzuar për veprën penale, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit te vlerave te mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do te ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 te Ligjit për Kompensimin e Viktimave te Krimit.

Vendimi për konfiskimin e një pushkë automatike ..., prodhim kinez, kalibër 7.62, me numër serik ... dhe një karikator i zbrazët pa fishek, u mor konfor nenit 366 par.3 të KPRK-së, dhe nenit 276 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 të KPP-së.

Bazuar në të lartëcekurat, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

2023:279677 datë 30.04.2024

Sekretarja Juridike,
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.